

Titulli i punës: _____
Nr. 03.59/18
Data 26.02.2018
PRISHTINË



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

RREGULLORE PËR PUNËN E BORDIT TË RTK-së

Prishtinë, Shkurt 2018

BORDI I RADIOTELEVISIONIT TË KOSOVËS PRISHTINË

Në bazë të Nenit 29, par. 2 dhe nënparagrafit 2.2 të Ligjit për Radio Televizionin e Kosovës (RTK) Nr. 04/L-046, si dhe Nenit 17, par. 1, nënparagrafit 2, të Statutit të Radio Televizionit të Kosovës, Bordi i Radio Televizionit të Kosovës, nxjerr:

RREGULLORE PËR PUNËN E BORDIT TË RTK-SË

Neni 1

Fushëveprimi

Me këtë Rregullore, përcaktohet mënyra e punës dhe e vendimmarrjes së Bordit të RTK-së (në tekstin e mëtejshëm Bordi), si dhe çështje të tjera me rëndësi për punën e tij.

Neni 2

Parimet

1. Bordi i përfaqëson interesat e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës;
2. Asnjë anëtar i Bordit nuk mund të pranojë ndonjë instruksion nga jashtë që do të ndikonte në pavarësinë e punës së tij;
3. Anëtarët e Bordit nuk i përfaqësojnë interesat e institucioneve që i kanë propozuar për anëtarë të Bordit;
4. Çdo anëtar i Bordit duhet ta kryejë punën e tij me nder dhe shkathtësi profesionale dhe intelektuale, konform Ligjit dhe Statutit të RTK-së, si dhe ligjeve dhe akteve të tjera pozitive në Republikën e Kosovës;
5. Anëtari i Bordit ka të drejtë për qasje në të gjitha informacionet lidhur me çështjet për të cilat ai duhet të vendosë.

Neni 3

Përbërja e Bordit

1. Bordi i RTK-së është organ kolegjal-drejtues i RTK-së;
2. Bordi i RTK-së përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë;
3. Anëtarët e Bordit të RTK-së janë personalitete të dalluara të fushave të ndryshme si: kultura, arti, kinematografia, gazetaria, drejtësia, biznesi dhe menaxhmenti, marrëdhëniet me publikun, marrëdhëniet ndërkombëtare, universiteti, media dhe teknika;
4. Anëtarët e Bordit duhet të jenë individë me kredibilitet dhe autoritet të lartë njerëzor, profesional dhe moral. Gjatë punës së tyre, anëtarët e Bordit duhet të jenë plotësisht të përkushtuar, objektivë dhe të paanshëm;
5. Anëtarët e Bordit emërohen dhe veprojnë në kapacitetin e tyre personal dhe nuk përfaqësojnë asnjë interes jashtë RTK-së përveç interesit të publikut. Ata nuk lejohet të kërkojnë apo pranojnë asnjë instruksion në lidhje me aktivitetet e Bordit nga asnjë interes jashtë RTK-së;
6. Përbërja e Bordit të RTK-së pasqyron karakterin shumetnik dhe gjinor të Kosovës. Së paku dy (2) anëtarë të Bordit të RTK-së emërohen nga komuniteti serb dhe një (1) anëtar emërohet nga komunitetet tjera jo shumicë dhe së paku dy (2) anëtarë të jenë të gjinisë femërore. Të paktën dy (2)

- anëtarë të Bordit do të kenë kualifikime profesionale në fushën e financimit, menaxhimit biznesor dhe të drejtësisë;
7. Anëtarët e Bordit duhet t'i përmbahen ligjit të aplikueshëm në Kosovë dhe e kanë të ndaluar që të kërkojnë dhe pranojnë udhëzime gjatë përmbushjes së detyrave të tyre prej cilitdo autoritet tjetër;
 8. Anëtarëve të Bordit u ndalohet keqpërdorimi i pozitës së tyre për përfitim personal apo të familjes së tij të ngushtë, të ndonjë pale tjetër apo entiteti.

Neni 4

Zgjedhja e anëtarëve të Bordit

1. Anëtarët e Bordit të RTK-së emërohen nga Kuvendi i Kosovës në bazë të procedurave të hapura dhe transparente;
2. Kandidatët për Bordin të RTK-së propozohen sipas procedurave të mëposhtme:
 - a) brenda nëntëdhjetë (90) ditësh para kalimit të mandatit të anëtarit të Bordit apo pas shpalljes së vendit të lirë për arsye të tjera, RTK bënë shpallje publike brenda një periudhe jo më të shkurtër se afati i përcaktuar me ligj;
 - b) Pesë (5) dite pas mbylljes së shpalljes publike, të gjitha aplikacionet RTK ia dorëzon Kuvendit të Kosovës, i cili themelon Komisionin ad hoc për shqyrtimin e tyre;
 - c) Brenda periudhës kohore prej tridhjetë (30) ditësh pas përfundimit të afatit për paraqitjen e kandidaturës, komisioni, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo pozitë në Bord, për të cilët konsideron se janë më të përshtatshmit në bazë të kompetencave, integritetit dhe përkushtimit të tyre për zhvillimin dhe përparimin e RTK-së;
3. Bazuar në Rregulloren e punës së Kuvendit, Kuvendi zgjedh njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë;
4. Mandati i anëtarëve të Bordit do të jetë si në vijim: katër (4) anëtarë të Bordit të RTK-së do të emërohen me mandat dy (2) vjeçar, katër (4) anëtarë me mandat tri (3) vjeçar dhe tre (3) anëtarë me mandat katër (4) vjeçar, dhe përcaktimi i kohëzgjatjes së mandatit nga secili grup do të bëhet me short;
5. Mandati i kryetarit dhe nënkryetarit të Bordit të RTK-së është dy (2) vite, me mundësi të rizgjedhjes vetëm edhe për një mandat;
6. Anëtarët e Bordit, mund të riemërohen vetëm edhe për një mandat tjetër tre (3) vjeçar.

Neni 5

Pamundësia për të qenë anëtarë i Bordit

1. Anëtar i Bordit të RTK-së nuk mund të jenë:
 - a) Anëtarët e familjes së ngushtë të stafit menaxhues;
 - b) Ish punonjësit të punësuar në RTK në dy (2) vitet e fundit;
 - c) Personat që mbajnë post publik të zgjedhur dhe të emëruar (funktionaret publik) apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy (2) viteve të fundit;
 - d) Është anëtar i organit udhëheqës të një partie politike apo personat të cilët kanë qenë në këto pozita gjatë dy (2) viteve të fundit;
 - e) Është anëtar i organit udhëheqës të ndonjë ndërmarrje publike;
 - f) Ka interes financiar të drejtpërdrejtë ose përfaqëson këtë interes, punon ose ka punuar në ndonjë transmetues në punët e telekomunikimit ose të transmetimit dhe në RTK në dy (2) vitet e fundit;
 - g) Të mos jetë i dënuar për veprë penale të dënueshme mbi gjashtë (6) muaj;

- h) Pronarët apo bashkëpronarët e medieve transmetuese ose bizneseve reklamuese, si dhe anëtarët e familjes së ngushtë të tyre apo edhe të punësuarit në këto media;
 - i) Është i/e angazhuar në aktivitete që mund të konsiderohen të jenë në kundërshtim dhe paraqesin konflikt të interesit siç është përcaktuar me ligjin në fuqi për parandalimin e konfliktit të interesit;
2. Anëtari i Bordit ose anëtari i ngushtë i familjes së tij nuk guxon të ushtrojë veprimtari afariste me institucionin publik të RTK-së.

Neni 6

Shkarkimi dhe dorëheqja e anëtarit të Bordit

1. Shkarkimi i anëtarit nga Bordi i RTK-së bëhet kur vërtetohet se ka ndonjë bazë për largim që parashihet me Ligjin e RTK-së;
2. Shkarkimi i një anëtari nga Bordi do të bëhet sipas procedurës në vijim: - propozimi për shkarkim vjen nga Bordi i RTK-së, me kërkesën e shumicës së thjeshtë të numrit të anëtarëve të Bordit ose të ndonjë iniciative tjetër nga jashtë, sipas kushteve të përcaktuara me Ligjin e RTK-së. Kuvendi i Kosovës me shumicë të thjeshtë do të vendosë për shkarkimin ose jo të anëtarit të Bordit;
3. Shkarkimi i anëtarëve të Bordit mund të bëhet sipas këtyre kushteve:
 - a) Paaftësisë profesionale - nëse në mënyrë të dëshmuar dhe në vazhdimësi;
 - b) Dështon t'i përmbushë detyrat e anëtarit të Bordit;
 - c) Paaftësisë mentale apo fizike për të kryer detyrat e anëtarit;
 - d) Nëse anëtari nuk i përmbush kushtet sipas nenit 26 të Ligjit të RTK-së;
 - e) Nëse ka dështuar të realizojë detyrat e tij/saj për një periudhë të pandërprerë prej më shumë se tre (3) muajsh, pa aprovim nga Bordi;
 - f) Nëse anëtari është dënuar për vepër penale, e cila është e dënueshme mbi gjashtë (6) muaj burg;
 - g) Nëse anëtari nuk i përmbush kushtet sipas nën-paragrafëve 1.3, 1.4 dhe 1.5 të paragrafit 1. të nenit 27 të Ligjit të RTK-së;
 - h) Mungesës në punë mbi një (1) muaj pa arsye;
 - i) Nëse ka marrë pjesë aktive në aktivitete politike pasi që është emëruar si anëtar i Bordit;
4. Anëtarët e Bordit mund të japin dorëheqje duke njoftuar me shkrim Bordin, të paktën tre (3) muaj përpara.

Neni 7

Kompetencat e Bordit të RTK-së

1. Bordi i RTK-së, punon dhe vepron në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe të Statutit të RTK-së;
2. Kompetencat e Bordit të RTK-së janë:
 - a) E aprovon statutin e RTK-së;
 - b) E aprovon rregulloren e punës së Bordit, si dhe rregulloret e tjera të përcaktuara me statut;
 - c) Shqyrton dhe miraton programet, bazat dhe standardet programore në përputhje me politikën programore, ligjin dhe standardet ndërkombëtare të informimit publik, sipas propozimit të drejtorit të përgjithshëm;
 - d) Shqyrton dhe miraton projekt-programin e produksionit të RTK-së, i cili duhet të jetë në përputhje me mundësitë financiare të RTK-së;
 - e) Shqyrton dhe miraton skemën e përgjithshme programore;

- f) Emëron dhe shkarkon, Drejtorin e Përgjithshëm të RTK-së;
 - g) Emëron dhe shkarkon zëvendës drejtorët e Përgjithshëm, drejtorët e Radiove dhe Televizioneve dhe udhëheqësin e shërbimeve të përbashkëta me shumicë të thjeshtë votash, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm;
 - h) Miraton strukturën organizative dhe konceptin programor të RTK-së;
 - i) E shqyrton dhe e miraton buxhetin vjetor dhe skemën për pagat e menaxhmentit dhe të personelit tjetër dhe siguron që shpenzimet e RTK-së nuk i tejkalojnë burimet e tyre financiare. Buxheti i RTK-së, është dokument publik, i cili pas shqyrtimit në Bord i adresohet themeluesit për shqyrtim dhe miratim;
 - j) Shqyrton dhe publikon më së largu deri më 31 mars të çdo viti raportin financiar vjetor të të hyrave dhe të shpenzimeve për vitin paraprak të përgatitur nga menaxhmenti i RTK-së, i cili i nënshtrohet një auditimi të jashtëm të pavarur. Raporti në fjalë më pas i dërgohet Themeluesit për trajtim dhe veprim;
 - k) Miraton planin programor vjetor, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, në përputhshmëri me ligjin dhe standardet ndërkombëtare dhe mandatin e RTK-së siç është përcaktuar me këtë ligj;
 - l) Miraton kodin e mirësjelljes për RTK-në dhe siguron zbatimin efektiv të saj;
 - m) Mbikëqyr paanshmërinë, objektivitetin dhe saktësinë e informacionit në programin e RTK-së;
 - n) Miraton kriteret kryesore profesionale për punësimin e personelit, politikave dhe procedurave të vlerësimit të përmbushjes së detyrave;
 - o) Siguron që janë ndërmarrë masat korrigjuese pas konstatimit nga ana e tij ose KPM-së se ka pasur shkelje të standardeve, rregulloreve dhe ligjeve të aplikueshme;
 - p) Vendos edhe për çështje të tjera të rëndësishme në përputhje me autorizimet dhe kompetencat që ka me ligj dhe statut;
3. Bordi i RTK-së themelon Komisionin e Auditimit prej pesë (5) anëtarësh, të cilët e zgjedhin kryesuesin e Komisionit;
 4. Bordi i RTK-së miraton Planin Vjetor të Punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm;
 5. Bordi i RTK-së shqyrton dhe miraton raportet periodike me rekomandime të Njësisë së Auditimit të Brendshëm të ofruara nga Komisioni i Auditimit dhe ato i adreson te Drejtori i Përgjithshëm;
 6. Bordi i RTK-së themelon edhe komisione të tjera të përkohshme dhe grupe punuese, sipas nevojave të Bordit;
 7. Bordi i RTK-së emëron Grupin Këshillues të Publikut, në pajtim me nenin 36 të Ligjit të RTK-së.

Neni 8

Veprimtaria dhe mënyra e punës së Bordit të RTK-së

1. Anëtari më i vjetër i Bordit të ri të RTK-së e konvokon mbledhjen e parë të Bordit të RTK-së sa më parë që është e mundur, e më së voni pesëmbëdhjetë (15) ditë nga dita e emërimit të anëtarëve të Bordit;
2. Bordi i RTK-së konsiderohet se është konstituuar nëse në mbledhjen e parë janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Bordit;
3. Kryetari i Bordit të RTK-së, të paktën një herë në muaj, thërret mbledhjet e rregullta të këtij Bordi. Mbledhjet e Bordit të RTK-së mund të konvokohen edhe me kërkesën e së paku pesë (5) anëtarëve të Bordit. Sipas nevojës mbledhjet e Bordit mund të konvokohen edhe më shpesh;
4. Kuorumi i mbledhjeve të Bordit të RTK-së është gjashtë (6) anëtarë;
5. Mbledhjet e Bordit i udhëheq kryetari në pajtim me Statutin dhe Rregulloren e punës të Bordit të RTK-së;

6. Në mungesë të kryetarit të Bordit, mbledhjet i udhëheq nënkryetari i tij;
7. Gjatë procesit të punës dhe vendimmarrjes, në Bordin e RTK-së, votimi është i hapur;
8. Bordi i RTK-së sipas Ligjit për RTK-së është i detyruar që për punën e vet t'i raportojë themeluesit të tij, në mënyrë të rregullt dhe të jashtëzakonshme;
9. Raportimi i rregullt i Bordit për punën e tij, bëhet në mënyrë periodike – njëherë në çdo tre (3) muaj dhe në fund të çdo viti. Raportimi i jashtëzakonshëm, bëhet sipas kërkesës së themeluesit;
10. Në mbledhjen e parë Bordi i RTK-së, me shumicë të thjeshtë votash, zgjedhë kryetarin dhe nënkryetarin e tij nga radha e anëtarëve të Bordit; nëse në mbledhjen e parë janë të pranishëm së paku dy të tretat (2/3) e anëtarëve të Bordit;
11. Votimi për zgjedhjen e kryetarit të bordit, bëhet me vota të fshehta;
12. Jo më shumë se dy (2) herë, anëtarët e Bordit, mund të propozojnë dhe votojnë kandidatin e njëjtë për kryetar dhe /ose nënkryetar të bordit;
13. Drejtori i përgjithshëm merr pjesë në mbledhjet e Bordit të RTK-së si anëtar pa të drejtë vote. Në mungesë të tij, Drejtori i Përgjithshëm mund të autorizojë një anëtar të menaxhmentit të lartë që të marrë pjesë në mbledhje;
14. Bordi i RTK-së, sipas nevojës mund të kërkojë që në mbledhjet e tij të marrin pjesë edhe anëtarët tjerë të menaxhmentit të lartë të RTK-së si dhe kryeredaktorët në prani dhe autorizim të Drejtorit të Përgjithshëm;
15. Komisioni i Auditimit dhe komisionet tjera të Bordit të RTK-së mbledhen të paktën një herë në muaj.

Neni 9

Detyrat e kryetarit dhe nënkryetarit të Bordit

1. Kryetari i Bordit është përgjegjës për udhëheqjen e Bordit, duke siguruar efikasitetin e tij në të gjitha aspektet e rolit të tij dhe përcaktimin e agjendës së Bordit;
2. Për t'i përmbushur përgjegjësitë e tij, kryetari i Bordit duhet:
 - a) Të sigurojë udhëheqjen e Bordit konform akteve ligjore;
 - b) Të bëjë konsultimet e nevojshme me anëtarët e tjerë të Bordit lidhur me mbledhjen pasuese të Bordit;
 - c) Të marrë pjesë dhe të kryesojë ato takime, duke u siguruar se të gjithë anëtarëve të Bordit u është dhënë mundësia për të shprehur pikëpamjet e tyre;
 - d) Të sigurohet që të gjithë anëtarët të pranojnë informata të sakta, të qarta dhe me kohë;
 - e) Të veprojë së bashku me Sekretarinë e Bordit për çështje që kanë të bëjnë me agjendat, raportet dhe dokumentet e Bordit, si dhe procesverbalet;
 - f) Të veprojë si pikë kontakti ndërmjet Bordit dhe menaxhmentit të RTK-së;
 - g) Të veprojë si pikë kontakti ndërmjet Bordit dhe themeluesit duke siguruar monitorim dhe raportim të lehtë;
3. Në mungesë të kryetarit apo me autorizimin e tij, detyrat e përshkruara në paragrafin 2 të këtij neni kryhen nga nënkryetari;
4. Kryetari i Bordit nuk mund të jetë kryesues i Komisionit të Auditimit dhe komisioneve të tjera të Bordit;
5. Kryetari i Bordit përkujdeset për zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të marra nga Bordi;
6. Kryetari i Bordit kryen detyra tjera të përcaktuara me Ligj dhe Statut të RTK-së.

Neni 10

Mbledhjet e Bordit

1. Mbledhjet e Bordit konvokohen nga kryetari i Bordit, përkatësisht nënkryetari, me autorizimin e kryetarit sipas nenit 8, Pika3, të kësaj rregulloreje;
2. Mbledhja e Bordit mund të konvokohet edhe me kërkesën e së paku 5 anëtarëve;
3. Mbledhja e Bordit mund të konvokohet edhe sipas kërkesës së Drejtorit të Përgjithshëm të RTK-së;
4. Bordi i RTK-së mban një mbledhje të rregullt mujore dhe mbledhje të jashtëzakonshme ose jo të planifikuara;
5. Me rastin e konvokimit të mbledhjeve të rregullta të Bordit, Sekretaria e Bordit obligohet që së paku tri ditë përpara datës së caktuar për mbledhjen të dërgojë tek anëtarët e Bordit agjendën e mbledhjes, e cila përmban datën, vendin dhe kohën e saktë të mbajtjes së mbledhjes. Me rastin e konvokimit të mbledhjeve të jashtëzakonshme të përshkuara në paragrafin 4 të këtij neni, anëtarëve të Bordit duhet t'u dërgohet agjenda bashkë me arsyen e konvokimit të mbledhjes si dhe materialet e nevojshme;
6. Pika e parë në agjendën e mbledhjeve të rregullta duhet të jetë gjithmonë aprovimi i procesverbalit të mbledhjes paraprake;
7. Agjenda e mbledhjes miratohet me shumicë votash nga anëtarët e pranishëm;
8. Secili anëtar është i lirë të propozojë përfshirjen e pikave në agjendë, duke arsyetuar nevojën për urgjencën e përfshirjes në agjendë. Dokumentet përkrahëse dhe vendimet e propozuara duhet t'i bashkëngjiten agjendës;
9. Bordi para marrjes së vendimit duhet që të konstatojë kuorumin e domosdoshëm. Bordi merr vendime me shumicë votash dhe plotfuqishmëria e vendimeve të Bordit është vetëm me shumicën e votave të përtej gjysmës së anëtarëve prezent në mbledhjen e Bordit;
10. Votimet në mbledhjet e Bordit janë të hapura, përveç rasteve kur parashihet ndryshe me Ligjin e RTK-së, me Statutin e RTK-së dhe me këtë rregullore;
11. Varësisht nga agjenda e Bordit dhe nga nevojat specifike për informacione shtesë dhe përkrahëse, Bordi mund të ftojë edhe persona të tjerë që nuk janë pjesë e RTK-së. Pjesëmarrja e personave të tjerë është e kufizuar vetëm për pjesën e mbledhjes për të cilën ata ftohen.

Neni 11

Procesverbali nga mbledhja e Bordit

1. Procesverbali i miratuar nga Bordi i RTK-së është dokument zyrtar nga i cili dalin vendimet e Bordit të RTK-së;
2. Mbledhjet e Bordit të RTK-së mund të incizohen tonikisht nëse për këtë paraprakisht merret vendim me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Në këto raste, Sekretaria obligohet që të nxjerrë transkriptin e saktë të incizimit të mbledhjes;
3. Procesverbali duhet të përmbajë:
 - a) Vendin, datën dhe kohën kur ka filluar mbledhja e bordit;
 - b) Emrin dhe mbiemrin e anëtarëve (dhe personave të ftuar) të pranishëm në mbledhje, si dhe emrat e anëtarëve që nuk janë të pranishëm;
 - c) Konstatimin e kuorunit;
 - d) Miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
 - e) Pikat e rendit të ditës;
 - f) Vendimet dhe mënyrën e votimit në mbledhje;
 - g) Rezultatet e sakta të votimit;

4. Nëse ndonjë anëtar i bordit ka mendim konkurrues për çështjen e caktuar, ai ka të drejte të sigurohet se deklarimi i tij është përfshirë tërësisht në procesverbal;
5. Procesverbali mbahet dhe përgatitet nga sekretari/ja administrativ/e;
6. Procesverbali i miratuar unanimitisht nga Bordi, nënshkruhet nga Kryetari i Bordit;
7. Pas nënshkrimit të procesverbalit nga kryetari, sekretari ua dorëzon nga një kopje çdo anëtarit të bordit.

Neni 12

Shfrytëzimi i aseteve të RTK-së

1. Bordi i RTK-së ka të drejtë të shfrytëzojë asetet e RTK-së për kryerjen e aktiviteteve zyrtare, si në vijim:
 - a) Pajisjet teknike;
 - b) Zyrë dhe inventar;
 - c) Telefonat fiks dhe mobilë;
 - d) Automjetet e RTK-së.

Neni 13

Grupi Këshillues i Publikut

1. Anëtarët e Grupit Këshillues të Publikut (në tekstin e mëtejshëm: GKP) emërohen nga Bordi i RTK-së në bazë të procedurave të hapura dhe transparente, nëpërmes konkursit publik;
2. GKP përbëhet nga tre shqiptarë, një serb dhe një pjesëtar nga komunitetet tjera, të cilët janë të regjistruar si banorë të Kosovës dhe kanë vendbanim të përhershëm në Kosovë. Tre anëtarët e tij duhet të jenë ekspertë në lëminë që është me rëndësi për punën e këtij Grupi Këshillues;
3. Anëtarët e GKP zgjidhen me mandat prej dy vitesh me mundësi të rizgjedhjes edhe për një mandat;
4. Anëtarët e GKP nga radhët e veta emërojnë dhe shkarkojnë Kryesuesin;
5. Grupi Këshillues i Publikut shqyrton:
 - a) Vërejtjet dhe sugjerimet e shikuesve dhe dëgjuesve;
 - b) E këshillon Bordin e RTK-së që të shqyrtohen çështjet e caktuara lidhur me programet e RTK-së;
 - c) Kryen punë të tjera të caktuara me këtë Statut;
6. Anëtarë të Grupit Këshillues të Publikut nuk mund të bëhen personat të cilët nuk mund të bëhen anëtarë të Bordit të RTK-së, në bazë të Nenit 27 të Ligjit për RTK-në;
7. Anëtarët e Grupit Këshillues të Publikut do të takohen të paktën katër herë në vit;
8. Anëtarët e Grupit Këshillues të Publikut kanë të drejtë në kompensim, të përcaktuar nga Bordi i RTK-së;
9. Puna e Grupit Këshillues të Publikut duhet të jetë publike dhe qëndrimet dhe rekomandimet e tij do të jenë publike;
10. Procedurat e emërimit dhe ndryshimit të anëtarëve të Grupit Këshillues të Publikut:
 - a) Zgjedhja e GKP bëhet përmes konkursit publik;
 - b) Bordi krijon një Komision ad-hoc përgjegjës për procesin e përzgjedhjes së GKP;
 - c) Bordi emëron anëtarët e GKP me propozimin e Komisionit ad-hoc.

Neni 14

Auditimi i Brendshëm

1. Auditimi i brendshëm i RTK-së kryhet nga Njësia e Auditimit të Brendshëm (në tekstin e mëtutjeshëm: NJAB);
2. NJAB-i i raporton Bordit të RTK-së në baza tremujore;
3. Bordi i RTK-së zgjedh anëtarët e NJAB-it nëpërmjet konkursit të hapur dhe duke u mbështetur në dispozitën e nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm;
4. NJAB-i ka udhëheqësin e saj, i cili njëkohësisht është edhe auditor i Brendshëm;
5. Udhëheqësi i NJAB-it në përmbushje të detyrave të tij, është llogaridhënës ndaj Komisionit të Auditimit dhe Bordit.

Neni 15

Komisioni i Auditimit dhe komisionet e tjera të Bordit

1. Bordi i RTK-së themelon Komisionin e Auditimit, i cili ka këto funksione:
 - a) Siguron mbikëqyrje të planeve dhe rezultateve të auditimit;
 - b) Siguron pavarësinë e Auditorit të Brendshëm (NJAB);
 - c) Vlerëson përshtatshmërinë e burimeve të auditimit;
 - d) Siguron që rekomandimet e auditimit janë pranuar dhe zbatuar;
 - e) Rekomandon Bordin mbi çështjet lidhur me reziqet, sistemet e kontrollit të brendshëm dhe auditimit;
 - f) Pranon raportet e auditimit të brendshëm me rekomandime, i shqyrton dhe i përcjell për miratim në Bord;
2. Bordi i RTK-së themelon Komisionin për Çështje Programore, i cili ka këto funksione:
 - a) Monitoron programet e RTK-së dhe vërejtjet ose sugjerimet ia rekomandon Bordit;
3. Bordi i RTK-së themelon Komisionin për teknologji dhe zhvillim, i cili ka këto funksione:
 - a) Mbikëqyrë çështjet teknologjike dhe politikat zhvillimore të produksionit të RTK-së. Vërejtjet dhe sugjerimet ia prezanton dhe rekomandon Bordit.

Neni 16

Dispozitat kalimtare


Bordi i RTK-së ka të drejtën e ndryshimit, plotësimit dhe ndërrimit të kësaj Rregulloreje.

Neni 17

Kjo Rregullore hyn në fuqi tetë ditë pas miratimit nga Bordi dhe nënshkrimit nga Kryetari i Bordit.

Prishtinë, 26 Shkurt 2018

Bordi i RTK-së, Afërdita Maliqi, kryetare





RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVIIZIJA KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

Në përputhje me nenin 29 dhe nenit 37 të Ligjit për Radiotelevizionin e Kosovës, nenit 20 Ligjit Nr. 06/L-021, për Kontrollin e brendshëm të financave publike, të nenit 34 të Statutit të RTK-së, të nenit 7 të Rregullores për punën e Bordit të RTK-së, të nenit 27 të Rregullores së auditimit të brendshëm, si dhe në bazë të neneve 4 dhe neni 6 i Udhëzimit administrativ MF -nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik, Bordi merr:

VENDIM

1. Për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për punën e Bordit të RTK-së. Ndryshohet pika 3 e nenit 7 të Rregullores për punën e Bordit të RTK-së, aty ku thuhet:

- Bordi i RTK-së themelon Komisionin e Auditimit prej pesë (5) anëtarësh, të cilët e zgjedhin kryesuesin e Komisionit.

Ndryshohet në përputhje me nenin 20 të Ligjit Nr. 06/L-021, për Kontrollin e brendshëm të financave publike dhe bëhet :

- Bordi i RTK-së themelon Komitetin e Auditimit të Brendshëm, i cili përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë, ku dy të tretat (2/3) janë të jashtëm nga fusha përkatëse e auditimit, ndërsa pjesa tjetër nga stafi i brendshëm i subjektit të sektorit publik.

2. Ndryshimet t'i bashkëlidhen Rregullores për punën e Bordit të RTK-së

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Kryetar i Bordit të RTK-së

Besnik Boletini



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Bordit të RTK-së;
- Sekretarisë së Bordit;
- U,d Drejtorit të Përgjithshëm
- Arkivit